



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA CËRRIK

Nr. \_\_\_\_ prot.

Cërrik, më 04.09.2023

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[04.09.2023]

Drejtuar: [BOE "Meteo" shpk me adrese: Fshati 'Cekin', Rruga Nacionale Gramsh Elbasan, Ndertese Private, Zona Kadastrale Nr. 1362, Nr. Pasurie 6/76, Prane Uzines & "Shendelli" me adresë Lagjja 'kastrioti', Rruga 'andon Profka', 2 Kullat Fier]

Procedura e prokurimit/lotit : **Procedure e hapur pune**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-75304-07-17-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Rikonstruksion i plote i shkolles 9-vjecare, ndertim i nderteses se kopshtit te femijeve, palestres, terreneve sportive fshati Selvijas, Nj.ADM Klos] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [24.07.2023] [64]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE "Meteo" shpk & "Shendelli" shpk Nr.Nipt **L26310801C & K07924803N**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera **80571605** [tetedhjetë milion e peseqind e shtatedhjetë e nje mije e gjashtëqind e pese ] leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. BOE "2N" shpk & "Ina" shpk me Nr. Nipt **L31615017L & J61814009W**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera **71000000** (shtatedhjetë e nje milion) leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

---

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE "2N" shpk & "Ina" shpk me Nr. Nipt **L31615017L& J61814009W**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet e mëposhtme*

Konstatohet qe dokumentacioni i paraqitur nga BOE i mesiperm ka mangesi si me poshte vijon:

1. Operatori ekonomik 2N sh.p.k. anetar i BOE ka paraqitur Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit ne te cilin nder te tjera deklarohet se: Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Operatori Ekonomik "2 N" sh.p.k deklarohet se ka paguar të gjitha detyrimet per taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqerore sipas legjislacionit ne fuqi. Nderkohe OE I mesiperm ka dorezuar ne sistem ekstraktin historik te ketij OE ku nder te tjera theksohet: Numri i ceshtjes: CN-121751-05-23, Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i shkresës Nr.21677 Prot, datë 19.05.2023, "Kërkesë për Vendosje të Masës së Sigurimit të Detyrimit Tatimor, lëshuar nga Drejtoria e Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore te Papaguara Rajoni Qendror , ku është kërkuar: Vendosje të masës së sigurimit të detyrimit tatimor, mbi subjektin: "2 N" SHPK pajisur me NUIS (Nipt)-L31615017L. Vendosja e kësaj masë synon të moslejohet tjetërsimi i titujve të pronësisë dhe të drejtat pasurore që i përkasin këtij tatimpaguesit deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore. Pra persa theksohet me lart ky OE ka deklaruar fals per pagesen e detyrimeve tatimore e persa me lart "Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.
2. Ne formularin e deklarimit BOE ka deklaruar se mbeshteten ne kapacitetet e operatorit ekonomik "Kupa" sh.p.k. sa i perket:
  - a. Licences Profesionale
  - b. Drejtues teknik Inxhinier ndertimi
  - c. Teknik ndertimi

Mangesite ne rastin konkret jane si me poshte:

Ne ligjin 162/2020 neni 84 pika 3 theksohet:

3. *Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

Ne rastin konkret nuk eshte parqitur asnje angazhim me shkrim te ketyre subjekteve per kete qellim.

Ne formularin e deklarimit theksohet se Gjithashtu ne legjislacion percaktohet se mbeshteten ne kapacitetet e operatorit ekonomik "Kupa" sh.p.k. sa i perket:

Licences Profesionale sa i perket licences NZ 4901/17 pikat NP 12B dhe NS 18B

Nderkohe qe ne formularin e OE Kupa sh.p.k. nuk theksohet nje mbeshtetje e tille por vetem mbeshtetje per:

- Znj. Entela Buzi, me profesion Inxhinier Ndertimi, e punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Drejtuesit Teknik
- Z. Izeir Spahiu, me profesion Teknik Ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë tonë në rolin e teknikut të ndërtimit.

Nga ana tjetër theksojmë se ne baze të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi" licenca e shoqerive sipas kategorive dhe klasifikimi i tyre behet ne baze te kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale pra nuk mund te sherbeje ne kete rast licence si nje kapacitet mbeshtetes. Legjislacioni i prokurimit publik e zgjidh ne kete rast nepermjet bashkepunimit ne formatin BOE dhe jo si mbeshtetese e OE apo BOE.

3. OE ekonomik 2N sh.p.k. si pjesetari i BOE me perqindjen me te madhe ne BOE duhet te paraqiste
  - a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurorhet që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e*

*shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. OE 2N sh.p.k. nuk ka paraqitur a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, po kështu ai nuk ploteson kushtin për b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet sipas shpjegimit të mëposhtëm:*

OE 2N ka paraqitur 27 file me emertimin pune të ngjashme nga të cilat rezultoi se:

Emertimi	AK	Mangesi
Rikonstruksion I tarraces se godines se paraklinikut dhe bodrumeve te godines se dekanatit te Fakultetit te Mjekesise Tirane	Fakulteti I mjekesise	Ne kontraten mes paleve nr. 502/19 date 31.08.2020 parashikohet ne nenin 2-2.27 se Periudha e garancise se difekteve eshte 24 muaj. Po kështu ne nenin 36-36.5 se periudha e garancise nis me daten e kolaudimit te punimeve. Ne kete rast duke qene se data e kolaudimit ishte data 19.04.2021 OE duhet te paraqiste Certifikaten e marrjes ne dorezim dhe jo ate te perkohshme. Gjithashtu certifikata e perkohshme e dorezuar nuk eshte e konfirmuar nga ana e AK. Persa me lart ky objekt nuk ploteson kriteret per kualifikim te kerkuara.
Rikonstruksion i godines se drejtorise se tatimeve Diber	Drejtoria e pergjithshme e tatimeve	Ne verifikim te situacionit konstatohet se ai eshte I vulosur nga drejtoria rajonale e Dibres dhe jo autoriteti kontraktor. Dhe ne rast te delegimit te firmes personi i autorizuar duhet te firmoste e vulosej me vulen e AK jo te drejtorise rajonale ne kundërshtim me LPP dhe rregulloreve per procedurat e punimeve te zbatimit.
Strukture magazinimi 1 kat dhe mur rrethues	Vaj ulla Shqiponja sh.p.k.	Ne formularin e vleresimit nga investitori konstatohet si date e perfundimit te punimeve data 31.12.2019 ndërsa ne aktin e kolaudimit percaktohet si date perfundimi data 17.12.2020 ne kohen kur afati i lejes se ndertimit te leshuar per kete rast ka qene 1 vit. Kjo date e deklaruar e perfundimit te punimeve bie ndesh gjithashtu dhe me licencen e kolaudatorit ku edhe pse ne formular deklarohet si date perfundimi data 31.12.2019 kolaudatori eshte pajisur me licence ne date 08.10.2020. Persa me lart rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.
Ndërtim I hyrjes kryesore dhe rikonstruksion I parkimit te automjeteve ne repartin 1001 Zall Herr	Komada e Forces Tokesore	Objekti ne fjale nuk konsiderohet I ngjashem me proceduren perkatese dhe nje konstatim I tille vihet re dhe ne pjesen e punimeve te marra persiper nga ana e 2N sipas kontrates se bashkepunimit. Persa me lart ky objekt nuk ploteson kerkesat per kualifikim.
Ndërtim ambulance fshati Silar	Bashkia Gramsh	Objekti ne fjale eshte i perfunduar ne afate persa i perket dorezimit perfundimtar te tij e ne rastin konkret OE duhet te paraqiste certifikaten perfundimtare te marrjes ne dorezim te punimeve e jo ate te perkohshme. Difektet apo mos leshimi I certifikates perfundimtare jane prova per mos realizimin me sukses te objektit.
Rikonstruksion I mjediseve te Prokurorise se	Prokuroria e rrethit	Objekti ne fjale eshte i perfunduar ne afate persa i perket dorezimit perfundimtar te tij e ne rastin konkret OE duhet te paraqiste certifikaten perfundimtare te marrjes ne dorezim te

Rrethit Gjyqesor Kurbin	gjyqesor Kurbin	punimeve e jo ate te perkohshme. Difektet apo mos leshimi i certifikates perfundimtare jane prova per mos realizimin me sukses te objektit.
Rikonstruksion I ambjenteve te brendshme te IML	Instituti I mjekesise ligjore	Objekti ne fjale eshte I perfunduar ne afate persa I perket dorezimit perfundimtar te tij e ne rastin konkret OE duhet te paraqiste certifikaten perfundimtare te marrjes ne dorezim te punimeve e jo ate te perkohshme. Difektet apo mos leshimi I certifikates perfundimtare jane prova per mos realizimin me sukses te objektit.
Rikonstruksion I salles se madhe te mbledhjeve te keshillit te qarkut Diber	Keshilli I qarkut Diber	Mungon certifikimi i marrjes ne dorezim nga institucioni ne kundershtim te rregulloreve per procedurat e punimeve te zbatimit
Sherbim mirembajtje objekti ndertimor...	Drejtoria e pergjithshme e arkivave	Objekti ne fjale eshte sherbim dhe jo pune pra nuk mund te konsiderohet I ngjashem me proceduren e prokurimit.
Rikonstruksion I magazines nr. 1 Agjencia German DRMSH Diber	Drejtoria e Pergjithshme e e Rezervave te Shtetit	Mungon certifikimi i marrjes ne dorezim nga institucioni ne kundershtim te rregulloreve per procedurat e punimeve te zbatimit
Rikonstruksion I plote per adaptim zyra, godina e repartit Marangoz dhe hidraulikut ne AQ Tirane	SHISH	Mungon certifikimi i marrjes ne dorezim nga institucioni ne kundershtim te rregulloreve per procedurat e punimeve te zbatimit
Rikonstruksion dhe pershtatje ambjenti ku do te instalohet MRI ...	Drejtoria e sherbimit spitalor Korce	Ndryshon data e perfundimit te punimeve ne procesverbalin e kolaudimit dhe te marrjes ne dorezim si dhe formularin e realizimit te objektit. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim
Rikonstruksion I shkolles 9 vjecare veiz Myslymi	Bashkia Fier	Objekti ne fjale eshte I perfunduar ne afate persa I perket dorezimit perfundimtar te tij e ne rastin konkret OE duhet te paraqiste certifikaten perfundimtare te marrjes ne dorezim te punimeve e jo ate te perkohshme. Difektet apo mos leshimi I certifikates perfundimtare jane prova per mos realizimin me sukses te objektit.
Rikonstruksion, sistemim asfaltim I sheshit te DRSHTRR Vlore...	Drejtoria e pergjishme e transportit	Objekti nuk eshte i ngjashem me objektin qe prokurohet. Objekti ne fjale eshte I perfunduar ne afate persa I perket dorezimit perfundimtar te tij e ne rastin konkret OE duhet te paraqiste certifikaten perfundimtare te marrjes ne dorezim te punimeve e jo ate te perkohshme. Difektet apo mos leshimi I certifikates perfundimtare jane prova per mos realizimin me sukses te objektit
Rikonstruksion I DRSHTRR Gjirokaster	Drejtoria e pergjishme e transportit te	Objekti ne fjale eshte I perfunduar ne afate persa I perket dorezimit perfundimtar te tij e ne rastin konkret OE duhet te paraqiste certifikaten perfundimtare te marrjes ne dorezim te punimeve e jo ate te perkohshme. Difektet apo mos leshimi I

	transportit Rrugor	certifikates perfundimtare jane prova per mos realizimin me sukses te objektit
--	-----------------------	--

Gjithashtu ky OE ka paraqitur kontrata qe plotesojne kriteret si me poshte vijon:

Emertimi	AK	BOE	Vlera pa TVSH perkatese
Rikonstruksion (perforcim) I objektit Fjetine-lavanderi Reparti ushtarak nr. 1040 Zall-Herr Tirane	Komada e Forces Tokesore	100%	9996355
Rikonstruksion I godines se komandes dhe shtabi I B2K per nevoja te komandes Tokesore	Komada e Forces Tokesore	100%	8209000
Ndertim Godine Banimi Dy kateshe	Investitor Privat	100%	8670583
Rikonstruksion ne DRSHTRR Diber...	Drejtoria e pergjithshme e Sherbimeve te transportit Rrugor	80%	29502309
Rikonstruksion Catie e Iyerje godine te gjykates	Gjykata e Apelit Gjirokaster	100%	966700
Nderhyrje riparimi ne Shkollen 4 heronjte	Bashkia Vlore	100%	1330750
Rikonstruksion I katit te trete te Pallatit te kultures Laberia...	Keshilli Qarkut Vlore	100%	1711987
Rikualifikim urban Ndertim lapidari...	Bashkia Cerrik	100%	1360348
Rikonstruksion I arkivit shteteror vendor Elbasan	Drejtoria e pergjithshme e arkivave	100%	6931296
Rikonstruksion I arkivit shteteror vendor Rreshen	Drejtoria e pergjithshme e arkivave	100%	6311340
Rikonstruksion I zyrave Pogradec	Drejtoria Rajonale e OSSHE sh.a. Korce	100%	7773436
Rikonstruksion ne objektet arsimore	Bashkia Elbasan	100%	4460894
			87224998

Nga sa konstatohet me lart vlera totale pa TVSH e punimeve te ngjashme eshte ne masen 87224998 leke. Ne rastin konkret ne zbatim te pikes *b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet* kerkohej qe OE 2N pjesemarrës ne BOE me 80% te sillte pune te ngjashme jo me pak se 132.912.547 leke.

Persa me lart OE nuk e ploteson kriterin e vecante per kualifikim.

- BOE nuk kane arritur ne kundershtrim me kerkesat e vecanta per kualifikim te paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbante kategorite e meposhtme:

**PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI**

- NP-12 B – Punime te inxhinerise se mjedisit

**PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

- NS-18 B – Punime topogjeodezike

5, Nga verifikimet ne buletinin e prokurimeve publike konstatohet se OE 2N sh.p.k. ka lidhur kontratat e punes:

- a. Bashkia Tirane, “Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Sharrë, data e lidhjes se kontrates 31.05.2023 afati I kryerjes se punimeve 15 jave kalendarike, vlera e kontrates 17,037,433.2 (shtatëmbëdhjetë milion e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e tre pikë dy) lekë me TVSH
- b. Bashkia Fier, Ndërtim i minifushave në shkollat 9-vjecare ‘Mark Dashi’, ‘‘Naim Frashëri’’, ‘‘Jani Bakalli’’, ‘‘Dino Ismaili’’, data e lidhjes se kontrates 18.05.2023, afati I punimeve 8 muaj, vlera e kontrates 17 139 142 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë e nente mijë e njëqind e dyzete e dy) leke me tvsh

Sa me lart ne verifikim te kerkesave per kualifikim ne te dy rastet konstatohet se OE 2N nuk ka ne dispozicion nje pjese te madhe te personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë pasi i ka te angazhuar ne procedurat e mesiperme e konkretishte per:

1 (një) Inxhinier Ndertimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Eletrik

1 (një) Inxhinier Gjeodet

1 (një) Inxhinier Mjedisi

5. Ne verifikim te procedurave te sipercituara konstatohet se OE 2N sh.p.k. nuk ka ne dispozicion per proceduren ne fjale nje pjese te stafit teknik punonjesit specialistë të kualifikuar ne profilet perkatese pasi e ka te angazhuar ne kontratat e mesiperme.
6. Ne verifikim te procedurave te sipercituara konstatohet se OE 2N sh.p.k. nuk ka ne dispozicion per proceduren ne fjale punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:
  - Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjes të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, si edhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise per periudhen prill 2023-qershor 2023.
  - Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjes pjese e stafit te shoqerise te jete i pajisur me çertifikate “Ekspert Zjarrefikes”, leshuar nga MZSH si edhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise per periudhen prill 2023-qershor 2023.(ose nepermjet kontraktimit me subjekte te licencuara)  
Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:
    - a) Kontrate pune;
    - b) diplome/certificate
7. Ne verifikim te procedurave te sipercituara konstatohet se OE 2N sh.p.k. nuk ka ne dispozicion per proceduren ne fjale nje pjese te makinerive per te cilat ka deklaruar dhe ne proceduren aktuale.

Persa me lart skualifikohet BOE ”2N” shpk & ”Ina” shpk.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë /**BOE ”Meteo” shpk me adrese:** Fshati 'Cekin',Rruga Nacionale Gramsh Elbasan, Ndertese Private,Zona Kadastrale Nr. 1362, Nr. Pasurie 6/76,

Prane Uzines & “Shendeli” me adresë Lagjja'kastrioti', Rruga'andon Profka',2 Kullat Fier/ se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **80571605** [tetedhete milion e peseqind e shtatedhete e nje mije e gjashteqind e pese ]leke pa tvsh]pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [**BASHKISE CERRIK, Lagja Nr.2 Ruga “Gjinnazistet 1962**] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ  
Tomorr Zaimaj**